



DYRRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

Nr. 109¹³ Prot.

Tiranë, me 07.08.2026

PROCESVERBAL

**MBI ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
KUALIFIKUESE PËR PROCEDURËN PËR BLERJEN E SHËRBIMIT
TRANSPORTI I LOJTARËVE TË AKADEMISË SË FUTBOLLIT DYRRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY - MARRËVESHJE KUADËR - ME NJË OPERATOR
EKONOMIK KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA – ME AFAT
GUSHT 2026 – KORRIK 2027.**

Autoritetit i Fondacioni Dyrrah City Football Academy, bazuar në nevojën e krijuar, do të prokurojë objektin për kontraktimin “Shërbim transporti i lojtarëve të Akademisë së futbollit Dyrrah City Football Academy - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat gusht 2026 – korrik 2027.

Në zbatim të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe me qëllim garantimin e një procesi konkurrues dhe përzgjedhjen e shërbimit më të përshtatshëm për nevojat e Akademisë, Fondacioni ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të procedurës së blerjes:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim transporti i lojtarëve të Akademisë së futbollit Dyrrah City Football Academy - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat gusht 2026 – korrik 2027.”

Tipi i kontratës: Marrëveshje Kuadër për Ofrimin e Shërbimit të transportit të lojtarëve të Akademisë së futbollit Dyrrah City Football Academy - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat gusht 2026 – korrik 2027.”

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,625,800 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind) lekë, pa TVSH

I mbajtur sot, më datë 07/08/2026, në ambientet e Fondacionit “Dyrrah City Football Academy”, në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit, të ngritur me Urdhrin nr.36, datë 07/08/2026 të Titullarit të Fondacionit, për miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”.



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

Mbështetur në nenin 18 të Rregullores së Brendshme për Administrimin e Procesit të Prokurimeve, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 18.06.2026, të Bordit Drejtues “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Administrimin e Procesit të Prokurimeve”, si dhe në funksion të nevojave të Fondacionit “Dyrrah City Football Academy”, Komisioni i Prokurimit shqyrtoi dokumentacionin e procedurës së hapur për prokurimin e shërbimeve të shërbimit të transportit.

Objekti i kontratës është ofrimi i shërbimeve të transportit për periudhën gusht 2026 – korrik 2027, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës së shërbimit, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

A. TERMAT E REFERENCËS:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti i shërbimit është ofrimi i transportit për lojtarët e Dyrrah City Football Academy nga qytetet Tiranë dhe Durrës në vendin e kryerjes së stërvitjes pranë Akademisë. Qëllimi i shërbimit është të sigurojë transport të sigurt, komod dhe të qëndrueshëm për lojtarët, duke plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe ligjore për transportin e fëmijëve dhe sportistëve.

Detyrat:

- Sigurimi i autobusëve me kapacitet prej 14, dhe 20 vende sipas nevojave të përcaktuara në itinerarë.
- Kryerja e 3 rrugëve vajtje-ardhje në ditë për çdo itinerar (Tiranë - Olympic Park Durrës – Tiranë, Durrës - Olympic Park Durrës – Durrës dhe Durres Plazh- Olympic Park Durrës- Durrës) nga e hëna deri të premten, si rregull.
- Automjetet duhet të jenë të pajisura me rripa sigurie për çdo pasagjer dhe me sistem kondicionimi. Ato duhet të jenë në gjendje të mirë teknike dhe të certifikuara për transportin e fëmijëve.
- OE duhet të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të automjeteve për të garantuar siguri dhe cilësi në çdo udhëtim.
- Shoferët duhet të jenë të licencuar, me përvojë në transportin e fëmijëve dhe të sportistëve, dhe të ndjekin rregulloret përkatëse të sigurisë.
- Shoferët të jenë të trajnuar dhe të kenë njohuri mbi kodin e sjelljes me fëmijët, duke firmosur deklaratën për përmbushjen e kësaj detyre.
- Automjetet duhet të jenë në gjendje teknike optimale, me kolaudim të vlefshëm dhe të plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore për transport publik.



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

- Raportimi i rregullt për përmbushjen e detyrave dhe çdo incident të mundshëm gjatë shërbimit.

Shpërndarja: Transporti do të ofrohet sipas orareve të përcaktuara për seancat stërvitore dhe aktivitetet e Akademisë, duke përfshirë udhëtimet ditore dhe shtesat e mundshme për evente të veçanta, në marrëveshje. Numri i automjeteve të nevojshme do të përcaktohet bazuar në numrin e lojtarëve dhe kapacitetin e mjeteve.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Pikat e grumbullimit të lojtarëve do të përcaktohen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të jenë brenda qytetit të Durrësit dhe Tiranës.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përcaktuar ose ndryshuar pikat e grumbullimit dhe itineraret sipas nevojave operationale dhe në përputhje me kushtet e marrëveshjes kuadër.

SHËRBIMI QË KËRKOHET:

Transport i lojtarëve të Akademisë së Futbollit Dyrrah City Football Academy, sipas itinerarit të përcaktuar në Marrëveshje.

Tabela Përmbledhëse e Parashikimit të Kërkesave për Shërbimin e Transportit
Sezoni Sportiv 2026–2027

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Kapaciteti minimal i mjetit	Itinerari i transportit	Numri i udhëtimeve të parashikuara gjatë periudhës së kontratës
1	Shërbim transporti në itinerarin Tiranë – Parku Olimpik / Fushat e DCFA	20 vende	Tiranë → Brryl → Pallati me Shigjeta → Sheshi Shqiponja → Maminas → Sukth → Fllak → Parku Olimpik / Fushat e DCFA	220
2	Shërbim transporti në itinerarin Tiranë – Parku Olimpik / Fushat e DCFA	14 vende	Tiranë → Brryl → Pallati me Shigjeta → Sheshi Shqiponja → Maminas → Sukth → Fllak → Parku Olimpik / Fushat e DCFA	440
3	Shërbim transporti në itinerarin Durrës – Parku Olimpik / Fushat e DCFA	20 vende	Veliera → Pallati i Sportit → Stadiumi → Këneta → Royal G → Kolegji Turk → Parku Olimpik / Fushat e DCFA	220
4	Shërbim transporti në itinerarin Durrës – Parku Olimpik / Fushat e DCFA	14 vende	Veliera → Pallati i Sportit → Stadiumi → Këneta → Royal G	440



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

			→ Kolegji Turk → Parku Olimpik / Fushat e DCFA	
5	Shërbim transporti në itinerarin Durrës – Parku Olimpik / Fushat e DCFA	14 vende	Ura e Dajlanit → Rrota e Kuqe → Plepa → Mbikalimi i Shkozetit → Mërshtull → Fllak → Parku Olimpik / Fushat e DCFA	660
6	Shërbim transporti ndërqytetas për zhvillimin e ndeshjeve sportive	Sipas nevojës	Transport Tiranë – Durrës (vajtje/kthim), me frekuencë 1 (një) herë në javë , sipas kalendarit zyrtar të ndeshjeve të Fondacionit.	44

B. SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

1. Fotokopje të certifikatës së regjistrimit/NIPT-it.
 - *Kriteri për paraqitjen e certifikatës së regjistrimit/NIPT-it synon të verifikojë statusin juridik të operatorit ofertues dhe identifikimin e tij si subjekt ekonomik i regjistruar*
2. Ekstrakt historik ose ekstrakt i thjeshtë nga QKB që vërteton se operatori ekonomik është në status aktiv dhe nuk ndodhet në procedurë falimentimi ose likuidimi.
 - *Kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të statusit aktiv dhe mosqenies në proces falimentimi synon të garantojë se operatori ofertues disponon kapacitetin juridik dhe organizativ për të përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet që rrjedhin nga kontrata*
3. Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale
 - *Ky kriter është vendosur për të verifikuar integritetin profesional dhe besueshmërinë e operatorit ofertues, duke garantuar që ai ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet profesionale, etike dhe ligjore*
4. Personat që ushtrojnë funksione administrimi, drejtimi ose përfaqësimi të operatorit ekonomik nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale që cenojnë besueshmërinë e operatorit ekonomik,
 - *Ky kriter është vendosur për të verifikuar integritetin profesional dhe besueshmërinë e stafit drejtues të operatorit ekonomik, duke garantuar që ai ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet profesionale, etike dhe ligjore*



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

5. Vërtetim i muajit të fundit nga administrata tatimore dhe Bashkia përkatëse që operatori ekonomik nuk ka detyrime tatimore dhe vendore të pashlyera
 - *Ky kriter është vendosur për të verifikuar gjendjen e rregullt fiskale të operatorit ofertues dhe për të garantuar që subjekti ushtron aktivitetin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme nga pikëpamja financiare*
6. Formularin e Ofertës, të firmosur dhe vulosur nga Operatori ofertues. Oferta duhet të përmbajë të dhënat e plota të personit të kontaktit (emër, mbiemër, numër telefoni dhe adresë e-mail).
 - *Ky kriter është vendosur për të garantuar vlefshmërinë zyrtare të ofertës, identifikimin e operatorit ofertues dhe shprehjen e qartë të interesit të tij për të marrë pjesë në procedurë dhe për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e kërkuar të blerjes.*
7. Vërtetim nga një bankë e nivelit të dytë ku specifikohet numri i llogarisë dhe IBAN-i në emër të subjektit
 - *Ky kriter është vendosur për të verifikuar të dhënat bankare të operatorit ofertues dhe për të garantuar identifikimin e saktë të subjektit për qëllime financiare dhe kontraktore gjatë zbatimit të kontratës*

2. KRITERET E VEÇANTA TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licënsa profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit, të leshuar në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operator”, të ndryshuar si dhe VKM Nr.89 datë 14.02.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operator”, të ndryshuar si dhe VKM Nr.89 date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të provojë përvojë në transportin e grupeve të organizuara, duke paraqitur të paktën një kontratë dhe dokumente që provojnë realizimin e saj (vërtetim realizimi, fatura, akt pranimi ose dokumente ekuivalentetë ngjashme të realizuar gjatë 2 (dy) viteve të fundit me institucione publike, organizata ose subjekte private.

Argumentimi: Komisioni i Prokurimit vlerëson se kërkesa që operatori ekonomik të provojë përvojë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të transportit për grupe të organizuara është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi. Shërbimi i transportit të sportistëve të Akademisë kërkon planifikim të rregullt të itinerareve, respektim të orareve të stërvitjeve dhe ndeshjeve, garantim të sigurisë së të miturve dhe aftësi për të menaxhuar transportin e grupeve në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë sezonit sportiv. Për këtë arsye, kërkesa për paraqitjen e të paktën një kontrate të ngjashme, të realizuar gjatë 2 (dy) viteve të fundit, së bashku me dokumentacionin që provon përmbushjen e saj (si vërtetim realizimi, fatura, akt pranimi ose dokumente të tjera ekuivalente), konsiderohet proporcionale dhe e domosdoshme për të verifikuar kapacitetin teknik dhe përvojën e operatorit ekonomik në ofrimin e shërbimeve të ngjashme. Kjo kërkesë synon të sigurojë që kontrata t'i besohet një operatori që ka dëshmuar më parë aftësi organizative dhe profesionale në realizimin me sukses të shërbimeve të transportit për institucione publike, organizata ose subjekte private

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon organizimin dhe kapacitetin profesional për të garantuar realizimin e shërbimit sipas itinerareve dhe orareve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Argumentimi: Komisioni i Prokurimit vlerëson se realizimi i shërbimit objekt prokurimi kërkon një nivel të lartë organizimi dhe kapaciteti profesional, pasi transporti i sportistëve do të kryhet sipas itinerareve dhe orareve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, të cilat mund të ndryshojnë gjatë sezonit sportiv në varësi të programit të stërvitjeve, ndeshjeve dhe aktiviteteve të tjera sportive.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të deklarojë se disponon strukturën organizative, burimet njerëzore dhe kapacitetin profesional të nevojshëm për të garantuar ofrimin e pandërprerë, në kohë dhe me cilësi të shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Ky kriter është proporcional me objektin e prokurimit dhe synon të sigurojë vazhdimësinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e shërbimit të transportit.



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratat e xhiros vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare (2024–2025). Vlera e xhiros vjetore për të paktën njërin prej këtyre viteve nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e fondit limit të procedurës pa tvsh.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë Fondacioni mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, Fondacioni mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Fondacioni të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për një periudhë maksimale 2 vitet e fundit financiare (2024 dhe 2025) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse të paktën njëri prej bilanceve nuk rezulton me kapital neto negativ

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë sigurimin e ofertës në masën 2% të fondit limit të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të paraqitet në formën e garancisë bankare ose garancisë së lëshuar nga një shoqëri sigurimi e licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së ofertës.

Argumentimi: Komisioni i Prokurimit vlerëson se kërkesa për paraqitjen e sigurimit të ofertës është e nevojshme për të garantuar seriozitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe për të mbrojtur interesat e Autoritetit Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës së



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

prokurimit. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e një shërbimi të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm për transportin e sportistëve të Akademisë gjatë gjithë sezonit sportiv, është thelbësore që operatorët ekonomikë të paraqesin oferta të mirëstudiuara dhe të qëndrueshme, duke shmangur tërheqjen e pajustificuar nga procedura ose refuzimin për të lidhur kontratën pas shpalljes fitues. Përcaktimi i sigurimit të ofertës në masën 2% të fondit limit konsiderohet proporcional me vlerën e procedurës dhe synon të balancojë mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor me garantimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurë”.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar realizimin e shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës, pavarësisht fluksit të pagesave nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Komisioni i Prokurimit vlerëson se operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar realizimin e pandërprerë të shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Shërbimi i transportit të sportistëve është një shërbim i vazhdueshëm dhe me rëndësi thelbësore për zhvillimin e procesit stërvitor dhe të aktiviteteve sportive të Akademisë, ndaj çdo ndërprerje e tij do të ndikonte drejtpërdrejt në veprimtarinë e Fondacionit. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të përballojë kostot operative të shërbimit, si karburanti, pagat e drejtuesve të mjeteve, mirëmbajtja e automjeteve, sigurimet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme, pavarësisht afateve të pagesave nga Autoriteti Kontraktor. Ky kriter konsiderohet proporcional me objektin e prokurimit dhe synon të minimizojë rrezikun e ndërprerjes së shërbimit për arsye financiare.”.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë saktësinë e dokumentacionit financiar të paraqitur nga operatori ekonomik pranë institucioneve kompetente

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Punë të ngjashme (e cila provon përvojën e mëparshme) për shërbime të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së përllogaritur të kontratës, konkretisht 7,087,740 (shtatë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë ose 76,106 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtë) euro, sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 06.08.2026, ku 1 euro = 93.130 lekë, dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë dy vjeteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e një përvoje të mëparshme për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 30% e fondit limit të kontratës synon të garantojë që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës që do të lidhet. Kjo përqindje përfaqëson një nivel proporcional dhe të arsyeshëm të eksperiencës së kërkuar në raport me madhësinë dhe kompleksitetin e kontratës në fjalë.

Vendosja e këtij kufiri në nivelin 30% është bërë duke pasur parasysh:

- Nevojën për të siguruar cilësinë dhe realizimin me sukses të shërbimeve.
- Ruajtjen e konkurrencës në procedurë, pa e kufizuar pjesëmarrjen vetëm për subjektet me përvojë të njëjtë ose më të madhe se vetë kontrata.
- Praktikën e zakonshme të prokurimit publik dhe rekomandimet e dhëna nga organet mbikëqyrëse.

Ky prag është një kriter i drejtë dhe objektiv për të garantuar përzgjedhjen e operatorëve të kualifikuar për realizimin e kontratës në mënyrë efektive.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për transportin rrugor për udhëtar të lëshuar nga Bashkia përkatëse ku ka selinë subjekti sipas neni 5 dhe 15 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, si dhe Licencë të specializuar për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. "Shërbimet e rregullta të specializuara" nënkupton shërbimet e rregullta, nga kushdo që është i organizuar, i cili siguron transportin e kategorive të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët e jere. Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë transportin:
a) shtëpi - punë, të punonjësve;
b) shtëpi - institucion shkollor, të nxënësve dhe studentëve.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

- a. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një Drejtues Teknik të pajisur me Certifikatë të Kompetencës Profesionale (CKP), të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Në mungesë të tij, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë pune ose kontratë shërbimi të vlefshme, e cila mbulon të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, të lidhur me drejtuesin e veprimtarisë që zotëron Certifikatën e Kompetencës Profesionale. Drejtuesi Teknik duhet të jetë i pasqyruar në Ekstraktin e QKB-së të operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Shoferë automjeti.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025) të siguruar për 3 muajt e fundit (maj, qershor dhe korrik 2026),

Drejtuesit e autobusit duhet të kenë:

1. Patentë e kategorisë D (minimumi 2 vite eksperiencë)
2. Kontratë punë të rregullt.
3. Certifikatën e aftësisë profesionale përkatëse (CAP).
4. Dëshmi penaliteti të paster.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Drejtuesi teknik ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e operacioneve të transportit dhe duhet të jetë i kualifikuar për të siguruar që aktivitetet e transportit të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore dhe të sigurisë, në përputhje me VKM nr.325 date 19.03.2008 "Per miratimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit et transportit rugor te mallrave dhe udhetarëve, si dhe per njohjen e dokumentave zyrtare, te caktuara per keta operatorë". Në lidhje me kërkesat e drejtuesve të autobusëve: Patentë e kategorisë D është një kërkesë thelbësore për drejtuesit e autobusëve, pasi ajo siguron që shoferët kanë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të drejtuar mjete të rënda transporti të udhëtarëve. Kjo është e nevojshme për të siguruar një transport të sigurt dhe të besueshëm, veçanërisht për grupe të rinjsh dhe fëmijësh, të cilët kërkojnë një nivel më të lartë të kujdesit dhe përgjegjësisë nga ana e shoferëve. Eksperienca deri në 2 vjet është e mjaftueshme për të siguruar që shoferët janë të njohur me kërkesat e sigurisë në rrugë dhe mund të reagojnë në



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

mënyrë adekuate në situata të papritura, pa pasur rrezik për të nxjerrë në situata të pasigurta pasagjerët, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë. Kjo kërkesë është në përputhje me Vendimin nr. 153, datë 7.4.2000 Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Kontrata e punës së rregullt është e nevojshme për të siguruar që shoferët kanë marrë angazhime të qarta dhe të ligjshme në lidhje me punën e tyre, duke përfshirë oraret e punës, pagën dhe detyrat e tyre. Kjo është e rëndësishme për të garantuar që shoferët janë të angazhuar plotësisht dhe kanë të drejta të plota punësimi, si dhe mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Certifikata e aftësisë profesionale (CAP) është e nevojshme për të siguruar që drejtuesit e autobusëve kanë kaluar një trajnim të detyrueshëm dhe janë të certifikuar për të drejtuar mjete transporti të pasagjerëve në përputhje me standardet e sigurisë, në përputhje me nenin 294, Vendimin nr. 153, datë 7.4.2000 Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Dëshmia e penalitetit e pastër është detyrim që rrjedh nga Politika e AK për Sigurinë e Lojtarëve, e lidhur me detyrimet kontraktuale me palë të treta.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 8 persona drejtues automjeti**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik deklaron disponimin e numrit minimal të punonjësve. Dokumentacioni provues kërkohet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Nga planifikimi i itinierareve të transportit për Akademinë, janë të planifikuara disa itinerare, të tilla si Tiranë – Durrës – Olympic Park Durrës – Tiranë dhe Durrës – Olympic Park Durrës – Durrës, me frekuenca të ndryshme. Duke marrë në konsideratë intensitetin e itinerareve (p.sh., frekuencën e udhëtimeve, numrin e vendeve të kërkuara, dhe kohën për udhëtim vajtje-ardhje), një numër minimal prej 8 shoferësh është i domosdoshëm për të garantuar mbulimin e të gjitha kërkesave të shërbimit.

Sipas planifikimit të Fondacinit, për ditën e hënë-të enjte:

Transporti Tiranë - Durrës me 20 Vende: 1 udhëtim (do të bëhet një herë në ditë). Ky udhëtim mund të kryhet nga një shofer dhe është i nevojshëm vetëm një herë në ditë.

Transporti Tiranë - Durrës me 14 Vende: 2 udhëtime (do të bëhen dy herë në ditë). Ky itinerar ka nevojë për dy shoferë, sepse do të bëhen dy udhëtime në ditë. Mund të kërkojë dy shoferë nëse udhëtimet janë të përhapura gjatë ditës, por gjithashtu mund të përdoret një shofer që bën udhëtimet më vonë gjatë ditës.

- Transporti Durrës - Durrës Olimpik Park me 20 Vende: 1 udhëtime (do të bëhet një herë në ditë). Ky udhëtim mund të kryhet nga një shofer dhe është i nevojshëm vetëm një herë në ditë.

- Transporti Durrës - Durrës Olimpik Park me 14 Vende: 2 udhëtime (do të bëhen dy herë në ditë). Ky itinerar ka nevojë për dy shoferë, sepse do të bëhen dy udhëtime në ditë. Mund të



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

kërkojë dy shoferë nëse udhëtimet janë të përhapura gjatë ditës, por gjithashtu mund të përdoret një shofer që bën udhëtimet më vonë gjatë ditës.

Kërkesa për disponimin e **minimumi 8 (tetë) drejtuesve të automjeteve** është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojat operative të shërbimit të transportit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Përveç itinerareve kryesore të transportit, operatori ekonomik duhet të garantojë edhe realizimin e itinerarit **Durrës – Plepa – Parku Olimpik**, si dhe shërbimin e **transportit ndërqytetas** për zhvillimin e aktiviteteve sportive, të cilat kërkojnë angazhim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore.

Gjithashtu, ky numër është vlerësuar i nevojshëm për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit edhe në rastet kur drejtuesit e mjeteve mungojnë për arsye shëndetësore, leje vjetore, pushime javore apo shkaqe të tjera të justifikuara. Disponimi i të paktën 8 (tetë) drejtuesve të automjeteve siguron që operatori ekonomik të ketë personel zëvendësues në dispozicion, duke shmangur ndërprerjen ose vonesat në ofrimin e shërbimit dhe duke garantuar realizimin e tij në përputhje me itineraret dhe oraret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Oraret e planifikuara janë në orën 13:30, 15:00, dhe 17:00. Disa udhëtime mund të kërkojnë më shumë se një shofer për të mbuluar oraret, sepse disa mund të përputhen dhe mund të kërkojnë më shumë kohë për të realizuar udhëtimin vajtje-ardhje. Për të garantuar mbulimin e të gjitha orareve, mund të ketë nevojë për një ekip të më të madh shoferësh që mund të mbulojnë oraret dhe të kenë kohë për pushime mes udhëtimeve (sidomos për itinerarët me më shumë udhëtime). Nëse disa udhëtime janë të ngjashme dhe kërkojnë shoferë të ndryshëm për të mbuluar intervalet e ditës, kjo do të kërkojë numër më të madh shoferësh për të shmangur ngarkesën e tepruar për çdo shofer. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e sigurisë së fëmijëve dhe të rinjve gjatë transportit, është shumë e rëndësishme që operatori ekonomik të sigurojë një staf të mjaftueshëm dhe të aftë për të menaxhuar ngarkesën e udhëtimeve pa e vënë në rrezik sigurinë e udhëtarëve. Kjo do të thotë që shoferët duhet të kenë mundësi për t'u ndërruar dhe për të marrë pushime të nevojshme, për të shmangur lodhjen që mund të ndikojë negativisht në sigurinë e lojtarëve të akademisë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Të paktën 8 (tetë) autobuse (në pronësi ose me qera) me vit prodhimi 2010 e sipër te cilet do të jenë në gadishmëri pranë AK gjatë afatit të zbatimit të kontratës të AK dhe sipas kërkesave të këtij të fundit. Autobusë me kapacitet jo më të vogël se 14 vende i pajisur me dokumentacion të plotë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë.

Për automjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi e automjetit (dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit);



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

2. Licencë për transport udhëtarësh (certifikatë) brenda vendit;
3. Certifikatë e kontrollit teknik të automjetit;
4. Siguracioni i mjetit;
5. Tahograf (i kolauduar);
6. Foto e automjetit.

Për automjetet që janë me qera duhet të paraqiten përveç sa më sipër edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Kujdes! Automjeti duhet të jetë i destinuar për shërbime të rregullta të specializuara të transportit të nxënësve të arsimit shkollor dhe parauniversitar, i pajisur me licencë për të tretë në transportin e udhëtarëve. Operatori ekonomik deklaron disponimin e numrit minimal të punonjësve. Dokumentacioni provues kërkohet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve të transportit, Fondacioni ka përcaktuar si kriter të domosdoshëm që operatori ekonomik fitues të disponojë të paktën 8 (tetë) autobusa me vit prodhimi 2010 e sipër, në pronësi ose me qira. Ky kriter është thelbësor për të siguruar që kontrata të zbatohet në mënyrë të pandërprerë dhe të përgjegjshme, duke përmbushur në mënyrë optimale kërkesat e AK. Së pari, disponimi i 8 autobusëve siguron që operatori ekonomik ka kapacitetin e mjaftueshëm për të përballuar të gjitha kërkesat e Fondacionit në çdo kohë. Duke pasur këtë numër mjeteve në gatishmëri, shmangen situatat e mungesës së burimeve dhe garantohen shërbime të vazhdueshme edhe në rastet kur nevojitet fleksibiliteti për itineraret ose numrin e udhëtimeve dhe zhvillimin e trajnimeve për lojtarët. (<https://www.wsj.com/articles/BL-DSB-8440>) Së dyti, kërkesa për mjete të prodhuara nga viti 2010 e sipër reflekton angazhimin për përdorimin e mjeteve moderne që plotësojnë standardet teknike dhe rregullat e sigurisë rrugore. Autobusët më të rinj ofrojnë një përvojë më të mirë për udhëtarët, duke përfshirë komoditetin, sigurinë dhe efikasitetin e konsumit të karburantit. Për më tepër, përdorimi i këtyre mjeteve kontribuon në uljen e ndotjes mjedisore, duke respektuar standardet bashkëkohore të mbrojtjes së ambientit. Së fundmi, kriteri që këto mjete të jenë në dispozicion dhe në gatishmëri për Fondacionin gjatë afatit të kontratës është i domosdoshëm për të garantuar një partneritet efektiv dhe një reagim të shpejtë ndaj kërkesave specifike të Fondacionit. Fleksibiliteti për t'i përdorur këto mjete sipas nevojave të AK siguron që shërbimi të jetë i përshtatur dhe i personalizuar për të përmbushur objektivat e tij operacionale.



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

2.3.6 Mjetet e transportit të jenë të pajisura me **aktvlerësimin në plotësim të kushteve për komoditetin e autobusëve** në transportin e udhëtarëve brenda vendit, të lëshuar në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; si dhe udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve” të ndryshuar.

Argumentimi: Komisioni i Prokurimit vlerëson se kërkesa që mjetet e transportit të jenë të pajisura me aktvlerësimin për plotësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin e udhëtarëve është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit objekt prokurimi dhe me detyrimin e Autoritetit Kontraktor për të garantuar transport të sigurt dhe cilësor për sportistët e Akademisë. Duke qenë se shërbimi do të ofrohet kryesisht për fëmijë dhe të mitur të grupmoshës 9–17 vjeç, është e nevojshme që automjetet të përmbushin standardet ligjore në fuqi për komoditetin dhe kushtet teknike të transportit të udhëtarëve. Për këtë arsye kërkohet që autobusët të jenë të pajisur me aktvlerësimin e lëshuar në përputhje me nenin 9 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, si dhe me udhëzimin nr. 1649, datë 16.08.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar. Ky kriter konsiderohet proporcional me objektin e prokurimit dhe synon të garantojë që shërbimi të realizohet me mjete që plotësojnë standardet teknike dhe të komoditetit të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke minimizuar rreziqet gjatë transportit të sportistëve.

2.3.7 Automjetet që do të përdoren për transportin e sportistëve duhet të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr.89 datë 14.02.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”. Pavarësisht se “Dyrrah City Football Academy” është një akademi sportive, njësia e prokurimit arsyeton se duke qenë që lojtarët e akademisë janë të moshës 5-19 vjeç, është i nevojshëm ndjekja e këtij standardi. Edhe pse Fondacioni nuk është institucion arsimor, Autoriteti Kontraktor aplikon këto standarde duke qenë se shërbimi ofrohet për fëmijë dhe të mitur të grupmoshës 5–19 vjeç, me qëllim garantimin e nivelit më të lartë të sigurisë gjatë transportit.

Shënim: Për transportin e nxënësve sipas VKM 89 datë 14.02.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve” AK kërkon që mjetet e transportit që do të ofrohen për nxënësit të plotësojnë kriteret e mëposhtme :

Neni 6 e VKM 89 datë 14.02.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve”



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

Pika 6.5- Automjetet që bëjnë transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve duhet të kenë të shkruar dukshëm, në mënyrë të rregullt, brenda xhamit të përparmë, me ngjyrë të zezë, fjalët "TRANSPORT SHKOLLOR". Në pjesën e pasme dhe anash vendoset logoja me shenjën e fëmijëve të shkollës, sipas fig. II 304, dhënë në vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Në këto mjete nuk duhet vendosur asnjë lloj reklame.

Pika 6.6 - Të gjitha automjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor profesional parauniversitar dhe universitar duhet të kenë të montuar në ndenjës rripat e sigurimit funksional dhe/ose ndenjëset e posaçme për fëmijët nga 4 deri në 12 vjeç.

Pika 6.7 - Çdo mjet i miratuar për këtë kategori transporti duhet të instalojë një sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server, deri në dy muaj, të cilat kontrollojnë të gjithë bordin e mjetit të transportit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë me një deklaratë se mjetet që ata disponojnë i përmbushin këto kritere.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Fondacioni

Në çdo rast, Fondacioni ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim

Operatori ekonomik deklaron se përmbush kriteret e mësipërme në ditën e hapjes së ofertave. Dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e këtyre kritereve do të kërkojnë vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara shpalljes fitues



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- Likuidimi i faturës objekt i procedurës së prokurimit do të kryhet brenda 20 ditëve nga lëshimi i dokumentit (faturës së shitjes) nga operatori ekonomik.

O.E fitues për lidhjen e kontratës duhet të paraqesë të gjithë dokumentat e kualifikimit, të cilat të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

- Operatori fitues do të shpallet operatori ekonomik që paraqet ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në çmimin më të ulët dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë dokument.

AFATI I DORËZIMIT TË OFERTAVE: Afati i dorëzimit të ofertave: Ofertat pranohen deri në ditën e Hënë , datë 17.08.2026, ora 12:00

Ofertat duhet të dërgohen elektronikisht në adresën: info@dcfa.al

Operatori ofertues i shpallur fitues duhet të paraqesë dokumentacionin origjinal pranë zyrave të Fondacionit “Dyrrah City Football Academy” brenda 2 (dy) ditë pune nga njoftimi i shpalljes fitues.

KOMISIONI I BLERJEVE MARRËVESHJE KUADËR

1. Arta Prendi (Kryetare)
2. Megi Gjuzi (Anëtar)
3. Fabio Dajzmaili (Anëtare)

Arta Prendi
Megi Gjuzi
Fabio Dajzmaili